



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. 746/12 .Prot

Datë 21.02 2022

VENDIM

NR. 18 , DATË 18.02 .2022

PËR

“MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i unifikuar, ligjit nr. 9131 , datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, i ndryshuar, ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksionit shtetëror”, ligjit 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin me publikun”, Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Pogradec dhe Institutit për demokraci dhe ndërmjetësim”,

KËSHILLI BASHKIAK  
VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Integritetit për Bashkinë Pogradec, i cili është pjesë integrale e këtij vendimi.
2. Ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi të gjitha drejtoritë përkatëse të Bashkisë Pogradec.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike.

KRYETARI I KËSHILLIT

Sotirag MANGËRI



# PLANI I INTEGRITETIT

**2022-2025**

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 18, Datë 18.02.2022





Institute for Democracy and Mediation  
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



### Grupi i Punës për hartimin e Planit të Integritetit në Bashkinë e Pogradecit

Paskalino Ziko, Nënkyetar i Bashkisë  
Klajda Gusho, Sekretare e Përgjithshme  
Ivana Capollari, Drejtore e Burimeve Njerëzore  
Irsa Karapança, Drejtore e Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar  
Elda Pengu, Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore  
Anxhela Piliniçi, Përgjegjëse e Taksave dhe Tarifave Vendore  
Erinda Kamolli, Përgjegjëse e Sektorit të Prokurimeve Publike

### Grupi i Punës, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim:

Dr. Rovena Sulstarova, Eksperte për Etikën dhe Integritetin  
Megi Reçi, Eksperte për Etikën dhe Integritetin  
Ledia Canga, Eksperte e Menaxhimit të Riskut

Ky Plan Integriteti është hartuar në kuadër të komponentit "Zgjerimi i praktikës standarde të planifikimit të integritetit në nivel vendor" të Projektit STAR3 "Mbështetja dhe Avancimi i Reformave të qeverisjes vendore". Projektin STAR3 zbatohet nga UNDP në Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe financohet nga Bashkimi Evropian dhe qeveritë e Suedisë dhe Zvicrës, UNDP në Shqipëri dhe nga vet Qeveria Shqiptare. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë dokument nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe mendimet e UNDP në Shqipëri, apo të partnerëve të saj zbatues dhe financues.



Funded by  
the European Union



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun Svizra  
  
Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



Sweden  
Sverige



MINISTRIA E BASHKËVETIMIT



## Deklarata e Integritetit Institucional

Bashkia Pogradec, duke e konsideruar integritetin një dimension jetik të qeverisjes së mirë, shtyllë të një shoqërie demokratike dhe një element kyç për sa i përket besimit publik tek institucioni, ka hartuar dhe miratuar këtë Plan Integriteti.

Plani i Integritetit i Bashkisë Pogradec synon menaxhimin e riskut të integritetit për fushat e përgjegjësisë së bashkisë, të forcojë kuadrin e brendshëm rregullator në aspekte të etikës dhe integritetit, të menaxhojë dhe zhvillojë burimet njerëzore për parandalimin dhe identifikimin e risqeve të integritetit, si dhe të forcojë llogaridhënien publike dhe transparencën në bashki. Plani mbështet promovimin e një kulture të vlerësimit të integritetit në nivel institucioni me synim identifikimin e risqeve dhe forcimin e rezistencës institucionale ndaj korrupsionit nëpërmjet zbatimit të masave parandaluese.

Nëpërmjet angazhimit për zbatimin e këtij Plani Integriteti, Bashkia Pogradec synon të rrisë përpjekjet institucionale antikorrupsion, të përmirësojë efektshmërinë operationale, transparencën, aksesin në informacion, llogaridhënien dhe të sigurojë një cilësi më të lartë shërbimesh për qytetarët. Duke e konsideruar këtë Plan Integriteti, si pjesë të pandashme të proceseve planifikuese të Bashkisë Pogradec, shprehim besimin tonë të plotë se zbatimi i tij do të kontribuojë në mënyrë pozitive në arritjen me sukses të objektivave për forcimin e integritetit të institucionit tonë.

Bashkia Pogradec është e vendosur të rrisë llogaridhënien, transparencën, efektivitetin e burimeve njerëzore, përmirësojë sjelljen dhe komunikimin brenda dhe jashtë institucionit, me qëllim rritjen e besimit publik dhe ofrimin e shërbimeve publike cilësore për komunitetin.

**Ilir Xhakolli,**

**Kryetar i Bashkisë Pogradec**



## Tabela e përmbajtjes

1. Rëndësia e Planit të Integritetit .....	5
1.1 Procesi i hartimit të Planit të Integritetit.....	6
1.2 Qasja metodologjike .....	8
2. Objektivat e identifikuarra dhe niveli i përgjithshëm i cenueshmërisë së integritetit.....	8
3. Plan i veprimit.....	10



## 1. Rëndësia e Planit të Integritetit

Plani i Integritetit është një mekanizëm institucional për parandalimin e korrupsionit dhe forcimin e integritetit të bashkisë. Kuadri rregullator për hartimin dhe zbatimin e këtij instrumenti në qeverisjen vendore në Republikën e Shqipërisë përfshin: Strategjinë Ndërsektoriale Antikorrupsion 2015-2020, objektivi A.11 i së cilës parashikon miratimin e politikave antikorrupsion në nivel vendor; Planin e Veprimit 2018-2020 në zbatim të Strategjisë, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 241/2018; Metodologjinë për Vlerësimin e Riskut të Integritetit për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, e rekomanduar për t'u zbatuar nga Ministria e Drejtësisë për zhvillimin dhe zbatimin e planeve të integritetit (shtator 2019).<sup>1</sup>

Plani i Integritetit do të ketë një rol shumë të rëndësishëm në realizimin e objektivave të mëposhtme për Bashkinë Pogradec:

1. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të riskut të integritetit me fokus në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë.
2. Plotësimi dhe forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit.
3. Forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit nëpërmjet menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore në bashki.
4. Forcimi i llogaridhënies publike dhe transparencës në bashki, për të siguruar rritjen e besimit dhe përfshirjes së publikut në veprimtarinë e bashkisë.

Bashkia Pogradec, ka zbatuar një proces gjithëpërfshirës të planifikimit të integritetit dhe të vlerësimit të riskut gjatë periudhës tetor-dhjetor 2021, i cili është finalizuar me hartimin dhe miratimin e Planit të Integritetit për Bashkinë. Plani i Integritetit është përgatitur duke u mbështetur në informacionin, sugjerimet dhe propozimet e ekipit të ekspertëve të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim në lidhje me zbatimin e dokumentit të Metodologjisë<sup>2</sup> si dhe në analizën e të dhënave dhe punën kërkimore të zhvilluar në bashki.

Plani i Integritetit, i miratuar me vendim nr. 18, datë 18.02.2022 të Këshillit Bashkiak, është i detyrueshëm për zbatim në Bashkinë Pogradec, dhe esenca e tij është parandalojë, zvogëlojë dhe eliminojë, mundësitë për zhvillimin e korrupsionit dhe parregullsive të tjera në institucion.

<sup>1</sup> MVRINJVV është hartuar nga IDM në kuadër të projektit "Forcimi i etikës dhe integritetit në Qeverisjen Vendore" në kuadër të projektit STAR 2 - Konsolidimi i Reformës Territoriale dhe Administrative, i zbatuar nga UNDP. Ky dokument është konsultuar me 61 bashkitë e vendit, institucionet publike që kanë në funksionet e tyre çështje të integritetit dhe është miratuar nga Ministria e Drejtësisë, Koordinator Kombëtar Antikorrupsion.

<sup>2</sup> Grupi i punës së integritetit në Bashkinë Pogradec, është asistuar nga ekspertët e IDM-së në kuadër të projektit "Zgjerimi i praktikës standarde të planifikimit të integritetit në nivel vendor" në kuadër të projektit STAR 3 - Konsolidimi i Reformës Territoriale dhe Administrative, i zbatuar nga UNDP.



## 1.1 Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit në Bashkinë Pogradec

Procesi i hartimit të Planit të Integritetit në Bashkinë Pogradec, filloi gjatë muajit tetor 2021 dhe përfundoi me miratimin e tij nga Këshilli Bashkiak në shkurt 2022. Ky proces përfshiu fushat e funksionale të bashkisë brenda të cilave u identifikuan risqe specifike që mund ndikojnë në efikasitetin dhe cilësinë e punës së institucionit. Në përfundim të procesit, ekipi i ekspertëve të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim, në konsultim me anëtarët e grupit të punës të caktuar nga kryetari i bashkisë, përcaktuan masat përkatëse për të parandaluar dhe eliminuar risqet e identikuara gjatë vlerësimit. Proceset e punës që u morën në analizë i përkasin shtatë fushave të funksionit të bashkisë, të pasqyruara në dokumentin e Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore: i) Fusha e menaxhimit financiar; ii) Fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore; iii) Fusha e kontrollit, auditimit dhe të mekanizmave kundër korrupsionit; iv) Fusha e shërbimeve publike; v) Fusha e administrimit dhe menaxhimit të pronave; vi) Fusha e planifikimit, administrimit dhe zhvillimit të territorit; vii) Fusha e arkivimit, ruajtjes, administrimit të dokumenteve dhe të informacionit, si dhe të dokumenteve elektronike.

Hartimi i Planit të Integritetit në Bashkinë Pogradec kaloi në fazat e mëposhtme:

### Faza 1: Përgatitja, komunikimi dhe mobilizimi i burimeve njerëzore

- Angazhimi institucional i Bashkisë Pogradec nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me IDM, për realizimin e procesit të vlerësimit të risqeve të integritetit.
- Miratimi i urdhërit të kryetarit të bashkisë për ngritjen e grupit të punës për zhvillimin e Planit të Integritetit në Bashki, të përbërë nga 7 persona, duke përfshirë drejtues dhe punonjës të drejtorive të bashkisë, që mbulojnë fushat që merren në analizë nga Plani i Integritetit.
- Prezantimi i Grupit të Punës me Metodologjinë për Vlerësimin e Riskut të Integritetit për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe me hapat e punës.
- Trajnimi i Grupit të Punës mbi çështjet e integritetit dhe etikës në administratën publike.
- Komunikimi i qëllimit dhe objektivave të Planit të Integritetit me administratën e bashkisë, nga ana e Grupit të Punës.

### Faza 2: Identifikimi dhe analizimi i risqeve të integritetit

- Punonjësit e administratës plotësuan një pyetësor në mënyrë anonime, në formë elektronike për të siguruar të dhëna dhe informacione për vlerësimin e sistemit të menaxhimit të integritetit. Anketimi është administruar në mënyrë elektronike dhe është bazuar në kampionimin dhe raportimin vullnetar të popullatës së studiuar. Përzgjedhja e individëve për të plotësuar anketimin u bazua në vullnetin e tyre për t'u përfshirë dhe ishte rastësore. Sondazhi përfshiu 81 punonjës të bashkisë, ndërsa shkalla e vlerësuar e gabimit është +/- 2% (me nivel besueshmërie statistikore 95%). Demografia e kampionit ka në përbërje shpërndarjen gjinore, moshore dhe të vjetërsisë në profesion të popullatës së synuar.
- Ekipi i ekspertëve të IDM, bëri vlerësimin e kuadrit ligjor dhe kuadrit të brendshëm rregullator të bashkisë për integritetin. Ky proces përfshiu monitorimin e Programit të Transparencës së



Bashkisë Pogradec si dhe shqyrtimin e dokumentacionit përkatës duke përfshirë: Rregulloren për Organizimin, Funkionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Bashkisë Pogradec; Rregulloren e Këshillit Bashkiak Pogradec; Vendimin për Miratimin e Strukturës, Organikës dhe Kategorizimit të Pozicioneve të Punës në Bashkinë Pogradec, njësisive administrative dhe institucioneve në varësi për vitin 2021; Rregulloren për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike në Bashkinë Pogradec; Raporte të Auditit të Brendshëm për Njësitë e Vartësisë; Raporte të Auditit të Brendshëm; Rregulloren e Brendshme për Procedurën e Shqyrtimit të Hetimit Administrativ të Sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit dhe sinjalizuesit në Bashkinë Pogradec; Kodin e Sjelljes së Mirë dhe Etikës për Bashkinë Pogradec dhe njësitë e vartësisë; Regjistrin e Realizimeve të Prokurimit Publik 2019; Rregulloren e Këshillit Bashkiak për Marrëdhënien me Publikun dhe Median; Rregulloren për Strukturat Komunitare dhe ndërveprimin e tyre me Këshillin Bashkiak; Rregulloren e Këshillit Bashkiak për Paraqitjen dhe Shqyrtimin e Ankesave, Vërejtjeve, Kërkesave, Peticioneve dhe Iniciativave Qytetare; Kodin e Sjelljes dhe Parandalimit të Konfliktit të Interesave të Këshilltarit Bashkiak; Raporte të Monitorimit të Buxhetit 2020-2021; Vendimin për Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore 2021; Politikën e privatësisë për përpunimin e të dhënave të mbledhura nëpërmjet faqes së internetit; Planin 6-mujor të Aktiviteteve të Këshillit Bashkiak, korrik-dhjetor 2020 etj.

- Ekipi i ekspertëve të IDM në bashkëpunim me grupin e punës të ngritur në bashki, ka zbatuar 7 fokus grupe me stafin e drejtorive të ndryshme të bashkisë, për të identifikuar risqet e integritetit për të gjitha proceset e punës dhe për të marrë këndvështrimet e tyre mbi ekspozimin e institucionit ndaj disa risqeve të caktuara.
- Grupi i punës përdori rezultatet dhe analizën cilësore për të vlerësuar situatën aktuale të ekspozimit të bashkisë ndaj korrupsionit dhe parregullsive të tjera.

### Faza 3: Vlerësimi i risqeve të integritetit

- Ekipi i ekspertëve të IDM bëri vlerësimin e risqeve të integritetit duke marrë në konsideratë mundësinë e ndodhjes apo shfaqjes së risqeve si dhe impaktin e tyre në integritetin e bashkisë.
- Në konsultim me grupin e punës të ngritur në bashki, risqet u renditën sipas prioritetit.

### Faza 4: Plani i veprimit për menaxhimin e integritetit dhe miratimi

- Grupi i punës propozoi masa, rekomandime, aktivitete, për parandalimin dhe vlerësimin e risqeve të identifikuara të integritetit.
- U vendosën afate dhe u përcaktuan përgjegjësitë konkrete të drejtorive për zbatimin e masave, rekomandimeve, aktiviteteve.
- Këshilli Bashkiak miratoi Planin e Integritetit.





## 1.2 Qasja metodologjike

Grupi i punës, në procesin e zhvillimit të planit të integritetit, ka zbatuar dy metoda kryesore për të analizuar dhe vlerësuar cenueshmërinë e integritetit: metoda cilësore dhe ajo sasiore. Hapi i parë ka qenë zhvillimi i një sesioni trajnues me grupin e punës dhe punonjësit e bashkisë, për metodologjinë e vlerësimit të integritetit për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Këtu përfshihet edhe analiza e Kuadrit të Brendshëm Rregullator dhe Strategjik të Bashkisë (shqyrtim literature), e cila përfshin: urdhra, manuale, strategji apo dokumente politikash, rregullore dhe akte të brendshme. Gjithashtu, u hulumtuan raporte të ndryshme mbi veprimtarinë e bashkisë. Në vijim, është kryer analizimi i të dhënave nga grupet e fokusuara me stafin e bashkisë. Takimet e fokusuara shërbyen për të identifikuar ngjarje negative në realizimin e proceseve të punës, praktika pune dhe funksione të cilat janë të ekspozuara ndaj shkeljeve të integritetit, sjellje joetike e joprofesionale dhe parregullsi të tjera.

Metoda tjetër e përdorur ishte ajo sasiore, përmes vlerësimit me anë të një pyetësori të strukturuar që pëfshinte pyetje mbi çështje të veçanta të integritetit dhe etikës në institucion. Pyetësori është një mjet shumë i rëndësishëm për mbledhjen e të dhënave të sakta dhe të kuantifikuara të risqeve të integritetit për aspekte të veçanta të integritetit në bashki. Këtij pyetësori punonjësit e bashkisë iu përgjigjën në mënyrë anonime.

Anketimi përfshiu një kampion me 81 punonjës të institucionit me një nivel statistikor besueshmërie 95%. Shkalla e vlerësuar e gabimit është +/- 6 %. Kampionimi përfshiu një shpërndarje të gjerë në lidhje me gjininë, moshën dhe vjetërsinë në punë. Të anketuarit meshkuj përbëjnë 30.9% të kampionit krahasuar me punonjëset gra që janë 69.1%. Punonjësit e moshës 26-35 vjeç kanë përqindjen më të madhe në kampion me 45.7%. Edhe të intervistuarit në moshë 36-45 vjeç janë të përfaqësuar mirë dhe përbëjnë 27.2% të kampionit. Kategoria e grup moshës 46-55 vjeç përfaqësojnë 17.3% të kampionit. Në përgjithësi, të anketuarit me më pak përvojë pune, (kategoria më pak se 5 vite pune), përbëjnë 54.3% të kampionit. Ndërkohë që kategoria me vjetërsi 5-10 vite pune përbën 34.6% të të anketuarve në bashki dhe ata me 11-20 vite pune përbëjnë 3.7%. Kategoritë e punonjësve me përvojë 21-30 vite pune dhe ata mbi 30 vite pune përbëjnë së bashku 7.4% të kampionit.

## 2. Objektivat e Planit të Integritetit

### 2.1 Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të riskut të integritetit me fokus në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë

Objektivi i parë i Planit të Integritetit të Bashkisë Pogradec, synon menaxhimin e riskut të integritetit për të gjithë bashkinë, me fokus në fusha të veçanta të përgjegjësisë si: fusha e menaxhimit financiar, menaxhimi i burimeve njerëzore, menaxhimi i pronave të bashkisë, shërbime publike si edhe planifikimi i territorit. Disa prej sfidave të identifikuara në këto fusha konsistojnë në: rregullim të ulët normativ të proceseve; paqartësi rreth proceseve dhe procedurave, linjave të hierarkisë dhe raportimit; kapacitete njerëzore të pamjaftueshme dhe



aftësi të kufizuara teknike në shumicën e proceseve të punës; mbingarkesë e punës; bashkëpunim i ulët ndërmjet drejtorive të bashkisë; infrastrukturë fizike dhe pajisje të pamjaftueshme në bashki etj.

## *2.2 Plotësimi dhe forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit*

Objektivi i dytë i Planit të Integritetit të Bashkisë Pogradec, synon forcimin e kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit. Bashkia e Pogradecit ka hartuar dhe miratuar një kuadër të gjerë rregullash dhe dokumente strategjike për aspekte të veçanta të integritetit, të tilla si: Rregulloren për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funkcioneve Publike në Bashkinë Pogradec; Rregulloren e Brendshme për Procedurën e Shqyrtimit të Hetimit Administrativ të Sinjalizimit dhe Mekanizmat e Mbrojtjes së Konfidencialitetit dhe Sinjalizuesit në Bashkinë Pogradec; Kodin e Sjelljes së Mirë dhe Etikës për Bashkinë Pogradec dhe njësitë e vartësisë etj. Megjithatë, rishikimi i kuadrit rregullator është i nevojshëm për të forcuar dhe qartësuar parashikimet ekzistuese, si dhe për të krijuar një kuadër rregullator efektiv, duke shtuar dispozita të caktuara që lidhen me çështjet e integritetit, duke siguruar përditësimin me ndryshimet më të fundit ligjore, rregullimin e qartë të funksioneve dhe detyrave si edhe duke pasqyruar ndryshimet që ka pësuar struktura institucionale.

## *2.3 Forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit nëpërmjet menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore në bashki*

Objektivi i tretë i Planit të Integritetit të Bashkisë Pogradec, synon menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore në bashki për parandalimin dhe identifikimin e risqeve të integritetit. Përmirësimi i proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion, do të sigurojë kapacitete dhe aftësi të nevojshme për të zbatuar dhe konsoliduar mekanizmat garantues të integritetit në institucion, me qëllim rritjen e profesionalizimit të personelit dhe zhvillimin në karrierë të zyrtarëve në përputhje me performancën në punë etj.

## *2.4 Forcimi i llogaridhënies publike dhe transparencës në bashki për të siguruar rritjen e besimit dhe përfshirjes së publikut në veprimtarinë e bashkisë.*

Objektivi i katërt i Planit të Integritetit të Bashkisë Pogradec, synon forcimin e llogaridhënies publike dhe transparencës në bashki, duke përmirësuar proceset e konsultimeve publike dhe përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje, si dhe duke përmirësuar transparencën proaktive. Përmirësimi i këtyre proceseve do të ndikojë në rritjen e besimit të publikut, përfshirjen e tij në veprimtarinë e bashkisë dhe reduktimin e hapësirave për vendimarrje që nuk konsiderojnë interesin publik.



### 3. Plani i Veprimit

Plani i Veprimit përfshin tërësinë e masave që synojnë të adresojnë risqet dhe faktorët e risqeve të integritetit, të identifikuar sipas fushave të përgjegjësisë së Bashkisë Pogradec. Ai është një mjet plotësues i politikave dhe kornizës rregullatore për përmirësimin dhe forcimin e integritetit institucional.

Monitorimi dhe raportimi i Planit të Veprimit është periodik (çdo vit) dhe pasqyron kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve/grupeve të punonjësve përgjegjës për zbatimin e masave të miratuara në të. Monitorimi do të përcaktojë nëse këto masa të zbatuara kanë qenë efikente, nëse kanë nxjerrë në pah ndryshime të kontekstit të institucionit apo ndryshime të vetë risqeve, të cilat mund të kërkojnë rishikimin e masave ekzistuese dhe prioritetëve të risqeve (planit të veprimit), si edhe nxjerrjen e mësimëve për planifikim më të mirë në të ardhmen. Raportimi është një procedurë e rregullt, që siguron zbatimin e Planit të Integritetit për risqet e integritetit sipas afateve kohore të parashikuara. Ky proces ndiqet nga personi përgjegjës, i caktuar nga titullari i institucionit, i cili është përgjegjës për të ndjekur progresin e zbatimit. Frekuenca minimale e raportimit është brenda një periudhe gjashtëmujore. Raportimi i lejon titullarit të ndër marrë me kohë masa përmirësuese, në rast se zbatimi i ndonjë mase të caktuar ka sjellë vështirësi apo vonesa.



**Objektivi 1.** Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të riskut të integritetit me fokus në fusha të veçanta të përgjegjësive së bashkë



Vr.	Fusha e Menaxhimit Financiar	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut	Masat prioritare Prioritet i lartë; Prioritet i moderuar; Prioritet i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteteve
1.	Fusha e Menaxhimit Financiar	Nivele të ulëta të zbatueshmërisë së paketës fiskale vendore për shkak të informacionit të papërditësuar dhe rakordimit të ulët me ZVRPP në lidhje me subjektet e tatueshme.	Operacional / Financiar	Mësaftar	<p>1. Nënshkrimi i një marrëveshje bashkëpunimi me ZVRPP për të rritur efikasitetin në shkëmbimin e informacionit të nevojshëm në lidhje me pasuritë e paluajtshme.</p> <p>2. Organizimi i inspektimeve bashkëpunimi të mbledhur të terrenit për të mblodhur të dhëna për subjektet e tatueshme; për saktësimin e sipërfaqeve të banimit dhe bizneseve, identifikimin e kateve të shtuara të ndërtesave; saktësimin e numrit dhe sipërfaqes së tabelave etj; për të mundësuar rritjen e efikasitetit në vjeljen e taksave</p> <p>3. Organizimi i fushatave ndërgjegjëse në komunitet për të bërë</p>	Drejtorja e Taksave dhe Tarifave Vendore  Gjastëmuji i dytë 2022



				informimin e tyre për detyrimet tatimore. (Për subjektet që banojnë në zona të pambuluara nga UK)	
2.	Mungesa e mjediseve fizike dhe kushteve të përshtatshme për arkivimin e dokumenteve financiare dhe prokurimeve dhe mbajtja e tyre nëpër zyrat përkatëse.	Operacional / Informacioni	Mesatar	1. Hartimi dhe miratimi i një rregullorje të brendshme për arkivimin, ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve financiare, në përputhje me legjislacionin në fuqi. (Siç parashikohet në Rregulloren e Këshillit Bashkiak.) 2. Trajnimi i stafit përkatës në lidhje me këtë rregullore. (Përfshihet në planin vjetor të trajnimeve.) 3. Vlerësimi i mundësisë për dedikimin e një ambienti të përshtatshëm për arkivimin e dokumenteve financiare dhe prokurimeve.	Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar + Sektori i Arkivë-Protokolli + Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse  1. Gjashtëmujori i dytë 2022 2. Gjashtëmujori i dytë 2022 3. Gjashtëmujori i parë 2024
3.	Mungesa e Planit Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë.	Operacional / Strategjik	Mesatar	1. Hartimi, konsultimi, miratimi dhe publikimi i Planit Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë.	Grup pune i krijuar me urdher të titullarit.  Gjashtëmujori i parë 2023



Nr.	Fusha e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Transparencës dhe Konsultimit Publik	Kategoria e faktorëve të riskut	Masat prioritare Prioritet i lartë, Prioritet i moderuar, Prioritet i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteteve
4.	Humbje e proceseve gjyqësore të bashkisë me ish-punonjës të saj me pasoja në imazhin dhe menaxhimin financiar të institucionit.	Operacional / Reputacioni	Mesatar	<p>1. Identifikimi i problematikave në kuadër të shkeljes për rastet e evidentimeve të largimit nga puna. Realizimi i takimeve të brendshme informuese nga DBNJ dhe Drejtoria Juridike lidhur me këto problematika. Koordinimi i vazhdueshëm mes këtyre drejtorive për shkëmbimin e informacionit në lidhje me këto raste.</p> <p>2. Parashikimi në Rregulloren e Brendshme i detyrimit për analiza të vijueshme të rasteve të tilla.</p> <p>3. Vëjimi i punës së grupeve teknike për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë.</p> <p>4. Marrja e masave të menjëhershme për plotësimin e vendeve të lira të punës me persona që kanë vendime gjyqësore të formës së prerë në përputhje me ligjin për nëpunësit civilë dhe aktet nënligjore të tij (udhëzimi për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë), si në rastin e lirimit të vendeve të punës apo</p>	<p>Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbeshtetëse + Drejtoria e Çështjeve Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve</p> <p>Gjashtëmujori i dytë 2022</p>



				dhe në kuadër të riskstrukturimeve institucionale dhe në vijimësi.	Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar + Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse  Gjashhtëmujori i parë 2024
5.	Kushte të papërshtatshme të ruajtjes së dosjeve fizike të personelit.	Operacional / Informacioni	Mesatar	<p>1. Vlerësimi i mundësisë për sigurimin e kushteve më të përshtatshme për ruajtjen e dosjeve fizike të personelit, për të garantuar mbrojtjen e të dhënave personale dhe aksesin vetëm nga personat e autorizuar.</p>	
6.	Mospërfundimi i procesit të ngarkimit të dokumentacionit elektronik të dosjeve të personelit, në sistemin HRMIS dhe aksesit i kufizuar i specialistëve të BNU në portalin administrata.al dhe sistemin HRMIS.	Burimet Njerëzore / Operacional	Mesatar	<p>1. Rishikimi i të drejtave të aksesit të punonjësve në sistem në bashkëpunim me DAP-in.</p> <p>2. Hartimi i një plani pune me afate të përcaktuara në lidhje me ngarkimin e dokumentacionit elektronik të dosjeve të personelit në sistemin HRMIS, duke përcaktuar edhe personat përgjegjës për ngarkimin e dokumentacionit.</p> <p>3. Organizimi i trajnimeve të brendshme në lidhje me përdorimin e HRMIS.</p>	Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse  Gjashhtëmujori i dytë 2022
7.	Vonesa/mangësi në procesin e vlerësimit të performancës në punë nga ana e eprorëve të drejtëpërdrejtë.	Burimet Njerëzore / Imazhi	Mesatar	<p>1. Organizimi i takimeve informuese nga DBNJ me drejtorët e bashkisë, në lidhje me procesin e vlerësimit të performancës në punë dhe rëndësinë e tij.</p>	Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse





					Gjashtëmujori i parë 2022 dhe në vazhdimësi
8.	Procesi i vlerësimit të punonjësve për performancën nuk përfshin vlerësimin e punonjësve për detyrat shtesë të caktuara (p.sh. detyra të caktuara me urdhër në rastin e koordinatorit për të drejtën e informimit.)	Burimet Njerëzore / Imazhi	Mësatar	<p>1. Përcaktimi në rregulloren e brendshme i detyrimit për kryerjen e analizës vjetore të performancës, si bazë për hartimin e planit vjetor të trajnimeve.</p> <p>2. Rishikimi i formularit të vlerësimit të performancës në punë duke shtuar një rubrikë fakultative për vlerësimin e detyrave shtesë të ushtruara nga personeli, në rastet kur punonjësit ushtrojnë detyra të tilla.</p>	<p>Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse + Grupi i punës i krijuar për rishikimin e rregullores</p> <p>1. Gjashtëmujori i dytë 2022 2. Gjashtëmujori i parë 2022</p>
9.	Mungesa e një plani të brendshëm për trajnimet e stafit.	Burimet Njerëzore / Operacional	Mësatar	<p>1. Hartimi dhe miratimi i një plani vjetor për trajnimet e brendshme nga DBNJ, bazuar në analizën e procesit të vlerësimit të performancës.</p> <p>2. Vlerësimi i mundësisë për alokimin e një zëri në buxhet për trajnimet e stafit.</p>	<p>Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse</p> <p>Gjashtëmujori i dytë 2022</p>
10.	Mungesa e hartimit të raportit vjetor të thyerjeve të Kodit të Etikës nga këshilltarët,	Burimet Njerëzore / Imazhi	Mësatar	<p>1. Hartimi dhe publikimi i Raportit Vjetor të thyerjeve të Kodit të Etikës nga këshilltarët. (sipas rregullores së KB)</p>	<p>Këshilli Bashkiak/Sekretari i Këshillit Bashkiak + Koordinatorin për</p>

				të drejtën e informimit	Gjashtëmujori i parë 2022
11.	Mungesa e regjistrit të të dhënave të rasteve të konfliktit të interesit në bashki.	Burimet Njerëzore	Mesatar	1. Hartimi i një regjistri për konfliktin e interesit dhe administrimi i tij nga DBNJ.	Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse
12.	Mungesa e regjistrit të deklarimit të dhuratave në bashki.	Burimet Njerëzore	Mesatar	1. Hartimi i një regjistri për deklarimin e dhuratave në bashki. 2. Informimi i personelit të bashkisë në lidhje me krijimin e regjistrit.	Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse
13.	Mungesa e qëndrueshmërisë së stafit të bashkisë si rrjedhojë e ristrukturimeve të institucionit.	Burimet Njerëzore / Imazhi		1. Kryerja e analizës së nevojave si parakusht i ndryshimeve strukturore. 2. Përcaktimi i këtij detyrimi në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë.	Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse
					Gjashtëmujori i dytë 2022

Nr.	Fusha e kontrollit, auditimit, mekanizmat kundër korrupsionit	Kategoria e faktorëve të diskut	Masat prioritare Prioritet i lartë; Prioritet i moderuar; Prioritet i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteteve
14.	<p>Rakordim jo i kënaqshëm mes drejtorive të bashkisë dhe drejtorisë së auditit në shkëmbimin e informacionit, objekt i veprimtarisë së auditit.</p> <p>Zbatim i ulët i rekomandimeve të auditit të brendshëm nga ana e drejtorive të bashkisë.</p>	Burrimet Njerëzore / Strategjik		<p>1. Rishikimi i Rregullores së Brendshme për të përcaktuar në mënyrë të qartë detyrimet e drejtorive të bashkisë në raport me njësinë e auditit, masat që merren në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, rregullat e komunikimit me këtë njësi, rregullat për shkëmbimin e informacionit duke reflektuar edhe ndryshimet në strukturën e brendshme. Rishikimi i rregullores rekomandohet të adresojë praktikën e standardeve të Institute of Internal Auditors (IIA).</p> <p>2. Kryerja e takimeve informuese me personelin e drejtorive në lidhje me ndryshimet në rregullore, rolin e auditit të brendshëm dhe detyrimet e secilës drejtori.</p> <p>3. Kryerja e një analize vjetore për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga të gjitha institucionet audituese (të brendshme dhe të jashtme) dhe</p>	<p>Grupi i Punës për rishikimin e rregullores + Sektori i Auditit të Brendshëm</p> <p>Gjashtëmuajori i dytë i 2022</p>



					përcjellja e kësaj analize tek kryetari i bashkisë.
15.	Mungesa e një strategjie për menaxhimin e riskut.	Operacional / Strategjik	Mesatar		<p>1. Parashikimi i detyrimeve të çdo njësie për parashikimin e risqeve dhe mënyrave të mitigimit të tyre. 2. Hartimi dhe miratimi i strategjisë për menaxhimin e riskut sipas modeleve dhe praktikave më të mira (COSO). 3. Shpërndarja e strategjisë pranë çdo njësie/drejtorie për të siguruar njohjen e metodologjisë së menaxhimit të riskut.</p>
					GMS
					Gjashtëmujori i dytë i 2022

	Fusha e Shërbimeve Publike				
Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut	Masat prioritare Prioritet i lartë; Prioritet i moderuar; Prioritet i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteteve
16.	Vështirësi në monitorimin e zonave të largëta si pasojë e mungesës së mjeteve të transportit	Burimet Njerëzore	Mesatar	<p>1. Vlerësimi i mundësive për alokimin e një zëri buxhetor për sigurimin e mjetit të transportit, për personelin e përfshirë në monitorimin e shërbimit për zonat më të largëta</p>	<p>Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar + Drejtoria e Shërbimeve Sociale</p>



